



Të dhënat e Maqedonisë së Veriut për të drejtat e njeriut do të shqyrtohen nga Rishikimi Periodik Universal

GJENEVË (29 prill 2024) – Grupi i Punës së Rishikimit Periodik Universal (RPU) i Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut do të shqyrtojë për herë të katërt të dhënat e Maqedonisë së Veriut në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut. Ky shqyrtim do të zhvillohet ditën e enjte më 2 maj 2024, gjatë një takimi që do të transmetohet drejtpërdrejt në [webcast live](#).

Maqedonia e Veriut është një prej 14 shteteve që do të rishikohet nga Grupi i Punës RPU gjatë seancës së radhës që do të zhvillohet më datat 29 prill -10 maj. [Rishikimi i parë, i dytë dhe i tretë](#) RPU i Maqedonisë së Veriut janë zhvilluar në muajin maj 2009, janar 2014, respektivisht janar 2019.

Dokumentet mbi të cilët bazohet rishikimi përfshijnë: 1) raportin kombëtar – informacion që ofrohet nga shteti subjekt i rishikimit; 2) informacionet që përmbajnë raportet e ekspertëve dhe grupeve të të drejtave të njeriut, të cilat njihen si Procedurat e veçanta, Organet e traktateve të të drejtave të njeriut dhe subjekte të tjera të OKB-së; 3) informacione të ofruara nga aktorët e tjerë, duke përfshirë institucionet vendase të të drejtave të njeriut, organizatat rajonale dhe grupet e shoqërisë civile.

Të tre **raportet** që shërbejnë si bazë për rishikimin e Maqedonisë së Veriut më 2 maj mund të gjenden [këtu](#).

Vendi: Salla 20, Palais des Nations, Gjenevë

Data dhe ora: 14.30 – 18.00, e enjte 2 maj (me orën e Gjenevës, GMT +2 orë)

RPU-ja është një proces që përfshin rishikimin periodik të të dhënave në lidhje me të drejtat e njeriut të 193 shteteve anëtare të OKB-së. Duke u nisur nga takimi i parë për këtë proces i mbajtur në muajin prill 2008, të gjitha 193 shtetet anëtare të OKB-së janë shqyrtuar tre herë. Gjatë ciklit të katërt të RPU-së, shtetet pritet që përsëri t'i bëjnë të ditura hapat që kanë ndërmarrë për të zbatuar rekomandimet e dhëna gjatë shqyrtimeve të mëparshme, të cilat kanë marrë angazhimin t'i zbatojnë, si dhe të theksojnë zhvillimet e fundit në lidhje me të drejtat e njeriut në vend.

Delegacioni i Maqedonisë së Veriut do të kryesohet nga Z. Igor Xhunde, Ambasador, Drejtor për marrëdhënie shumëpalëshe, Ministria për punë të brendëshme.

Të tre përfaqësuesit e shteteve që do të luajnë rolin e raportuesve ("trojka") për rishikimin e Maqedonisë së Veriut janë: Shqipëria, Benini dhe Finlanda.

Seanca do të transmetohet në **webcast** në [North Macedonia Review - 46th Session of Universal Periodic Review | UN Web TV](#).

Lista e folësve dhe të gjitha deklaratat që do të bëhen gjatë rishikimit të Maqedonisë së Veriut do të postohen në [UPR Extranet](#).

Grupi i Punës RPU **pritet të miratojë rekomandimet** për Maqedoninë e Veriut prej 15.30 – 18:00, të merkurën më 8 maj 2024. Shteti subjekt rishikimi mund të dëshirojë të shprehë pozicionet e veta në lidhje me rekomandimet e dhëna gjatë rishikimit.

// FUND //

Për më shumë informacion dhe kërkesa nga mediat, ju lutemi kontaktoni Paskal Sims, zyrtar për media në KDNj në: simp@un.org; Mathju Braun, zyrtar për informim publik në KDNj në matthew.brown@un.org; dhe David Diaz Martin, zyrtar për informim publik në KDNj në david.diazmartin@un.org.

Për të mësuar më shumë rreth Rishikimit Periodik Universal, vizitoni: [Universal Periodic Review | OHCHR](#)

Këshilli i Të Drejtave të Njeriut i OKB-së; na ndiqni në mediat sociale: [Facebook](#) [Twitter](#) [YouTube](#) [Instagram](#)